



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. ... Prot. 757/1

Tiranë, më 15.10.2015

UDHËZIM

Nr. 43, datë 15.10.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 37, DATË 05.10.2015 "PËR PROCEDURËN E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË, TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË, SI DHE PËR TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË PROGRAMET E STUDIMIT TË OFRUARA NGA KËTO INSTITUCIONE, PËR VITIN AKADEMIK 2015 - 2016"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 5 të nenit 33, pikës 1 të nenit 34, dhe të nenit 35 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 37, datë 05.10.2015 "Për procedurën e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, të ofruara nga institucionet private të arsimit të lartë, si dhe për transferimin e studimeve në programet e studimit të ofruara nga këto institucione, për vitin akademik 2015 - 2016", në fund të pikës 21 të shtohet përcaktimi si më poshtë:

"Bëjnë përjashtim nga përcaktimi i mësipërm vetëm programet e përbashkëta, të ofruara në bashkëpunim me IAL të huaja. IAL-ja private që ofron programin e përbashkët, veç përcaktimeve në marrëveshjen mes palëve për programin përkatës të studimit, mund të përcaktojë dhe kritere të tjera shtesë sipas parashikimeve në aktet e saj të brendshme."

2. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si edhe institucionet private të arsimit të lartë.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

